

Bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, nenit 4 të UA 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik nenit 4 të Rregullores mbi Marrëdhënjen e Punës të punëtorëve të KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë, Kryeshefi Ekzekutiv i Kompanisë publikon këtë:

RISHPALLET KONKURSI

Pozita: Roje në Radave NjO Pejë.

Ekzekutues: 1 (Një)

Kohëzgjatja e Kontratës: Kontrata lidhet për kohë të caktuar (6 muore), me mundësi vazhdimi varësisht nga angazhimi i të punësuarit.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Te zbatohet me korrektësi dhe përgjegjësi disiplinën në punë dhe zbatimin e detyrave të ngarkuara;
- Të raportoj mbi gjendjen e lënë, gjatë ndrrimit të tij.
- Në rast të Avarisë në Kompani të ndërmerr masa preventive.
- Të raportoj me kohë për çfarëdo defekti në paisje.
- Të mbajë vendin e punës të pastër dhe të rregullt.
- Të mos lejoj personat e paautorizuar të hynë në objekt.
- Për çdo rast të rrezikut të informoj menaxherin dhe organet përgjegjëse.
- Kryen edhe detyra të tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikqyrësi;

Kërkesat/Kualifikimet Profesionale:

- Diploma e shkollës së mesme;
- Të ketë aftësi të mira komunikuese;
- Kopja letërnjoftimit;
- Çertifikatën që kandidati nuk është nën hetim;
- Dëshmi për përvojën e punës;

Aplikacionet mund të merrenë në zyrën Burimeve Njerëzore të KRU “Hidrodrini” Sh. A. Rr. “Lekë Dukagjini” Nr.156 Pejë dhe Web – faqen “Hidrodrini” Sh. A. www.hidrodrini.com.

Aplikacionit i bashkangjiten kopje të dokumentacionit mbi kualifikimin, për përvojën e punës, dokumente tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës për të cilën konkurrojnë kandidatët. Aplikacioni dhe dokumentet përcjellëse dorëzohen në KRU “Hidrodrini” Sh. A. Zyra e Burimeve Njerëzore në pliko të mbyllur në adresën:

Rr. “Lekë Dukagjini” nr.156 - Pejë (afër Patrikanës së Pejës).

Shpallja do të jetë e hapur 15(pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit, në shtypin ditore dhe Web – faqen www.hidrodrini.com.

Kandidatët që ftohen në intervistë janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale për verifikim para komisionit intervistues.

Kandidatët që hyjnë në përzgjedhje të ngushtë, do të informohen lidhur me intervistën nëpërmjet telefonit ose me shkrim në afat ligjor nga zyra e Burimeve Njerëzore.

Aplikacionet e dërguara pas afatit të cekur më lartë nuk do të pranojnë. Dokumentat jo të kompletuara do të refuzohen. KRU “Hidrodrini” Sh. A. ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës.